



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister**

**Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Statistical Agency of Kosovo**

---

## **REGJISTRIMI I POPULLSISË NË KOSOVË 2021**

**Harta rrugore për regjistrimin e popullsisë dhe  
ekonomive shtëpiake**

Prishtinë,  
Mars 2018<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Dokumenti është azhurnuar në vitin 2019

## Përmbajtja

Hyrje.....	3
1. Regjistrimi i popullsisë ka një dimension të fuqishëm nacional dhe internacional .....	4
2. Nevoja për të dhënat e regjistrimit .....	5
3. Regjistrimet e popullsisë i zbatojnë standardet internacionale.....	6
4. Shtrirja dhe kostoja e regjistrimit në Kosovë .....	7
5. Puna përgatitore .....	8
AKTIVITET KRYESORE, AFATI KOHOR DHE PERGJEGJËSIT PËR NJË REGJISTRIM TË SUKSESSHËM (deri te data e regjistrimit) .....	9
6. Struktura organizative .....	9
7. Ligji.....	9
8. Buxheti.....	10
9. Metodologjia.....	11
10. Grumbullimi i të dhënave në terren (TI).....	11
11. Hartografia/GIS.....	12
12. Logjistika .....	13
13. Komunikimi .....	14
14. Administrata.....	15
15. Testet para regjistrimit .....	16
16. Pilot regjistrimi .....	16
17 Regjistrimi në terren.....	17
18. Anketa post regjistruese (APS/PES).....	18
19. Analizimi dhe tabelimi .....	18
20. Të dhënat preliminare .....	19
21. Të dhënat finale.....	20
22. Raportet tjera specifike.....	21
23. Dërgimi i të dhënave tek institucionet lokale dhe ato ndërkombëtare / diseminimi .....	21
24. Regjistri i popullsisë/lidhja me bazat tjera .....	22
25. Konkluzione dhe rekomandime kryesore .....	23
26. Rreziqet e mundshme.....	23
27. Aktivitetet e planifikuara të radhës në periudhën 2019-2022.....	24

## Hyrje

Për shkak të kompleksitetit të Regjistrimit të Popullsisë, ASK-ja e ka zhvilluar këtë dokument si burim themelor për aktivitetet kryesore, derisa të tjera dokumente, si plani i detajuar i aktiviteteve dhe buxheti, duhet të azhurnohen bazuar në situatën që do të zhvillohet procesi. Ky dokument është përgatitur në fund të vitit 2018 një azhurnuar në maj 2019.

Deri në fund të vitit 2019, ASK duhet të ketë / prezantuar planin strategjik të detajuar

Regjistrimi i popullsisë në vitin 2021 për institucionet që organizojnë dhe zhvillojnë regjistrimin është një kohe shumë e shkurtër marrë parasysh angazhimin dhe përgatitjet e duhura që duhet për një projekt të tille madhor dhe të rëndësishëm.

Regjistrimi i popullsisë ka implikime të mëdha në shumë sfera socio-ekonomike në vend përfshirë aspektin politik, organizimin më të mirë të shpërndarjes së fondeve tek nivelet e ndryshme, mundëson planifikime më të mira duke u bazuar në të dhëna si dhe mundëson një parashikim më të mirë për të ardhmen.

Pasi regjistrimi i parë në Kosovë pas pavarësisë ishte ai i vitit 2011 (një kapitull i veçantë) ky Regjistrim i popullsisë në vitin 2021 për Kosovën është shumë i rëndësishëm dhe specifik pasi shërben si një instrument për të parë zhvillimet demografike dhe ato socio-ekonomike gjatë këtyre viteve.

Marrë parasysh zhvillimet teknologjike që kanë ndodhur gjatë kësaj dekade, ASK do të implementojë një pjesë të teknologjisë në disa faza të aktiviteteve duke ngritur, mbulueshmërinë, kualitetin si dhe shpejtësinë e publikimit të të dhënave.

Regjistrimi i popullsisë në Kosovë do të zhvillohet në harmoni me rekomandimet e fundit për Regjistrime të bëra nga Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropë<sup>2</sup> si dhe nevojave të vendit për të dhëna.

Sot, të dhënat konsiderohen si një e mirë publike dhe institucionet statistikore duhet t'i përshtaten kërkesës gjithnjë e më të madhe për të dhëna duke respektuar standardet e reja ndërkombëtare - gjithmonë e më të detajuara - për definicionet që duhen aplikuar dhe metodologjitë që duhet ndjekur.

---

<sup>2</sup> UNITED NATIONS ECONOMIC COMMISSION FOR EUROPE: Conference of European Statisticians, Recommendations for the 2020 Censuses of Population and Housing, UNITED NATIONS, New York and Geneva, 2015

## **1. Regjistrimi i popullsisë ka një dimension të fuqishëm nacional dhe internacional**

Regjistrimet e popullsisë kanë fuqinë për të gjeneruar një profil të gjerë me të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse në aspektin demografik, social dhe ekonomik të një vendi që është një bazë e rëndësishme për qeverisje të mirë dhe vendimmarrje.

Regjistrimi i popullsisë dhe ekonomive shtëpiake është instrumenti më unikë për sigurimin e një profili të tillë komplet dhe të thellë. Në nivel të agregateve (grupeve) më të vogla regjistrimi konsiderohet si mjet fundamental për promovimin e politikës në nivel lokal dhe regjional, dhe në aspektin nacional ai lejon një revolucion dhe udhëzim të politikës, ndërsa në nivelin internacional ai është thelbësor për monitorimin e marrëveshjeve dhe negociatave multilaterale politike.

Në shkallën botërore, regjistrimet gjykohen të jenë si burime më të sigurta për monitorimin e objektivave zhvillimore të mileniumit të miratuara nga Kombet e Bashkuara dhe procese tjera globale.

Shumë vështrime, analiza dhe vendimmarrje në nivelin ndërkombëtar bazohen në të dhënat nga regjistrimet e popullsisë marrë parasysh gjithë përfshirjen dhe krahasimin e të dhënave me vendet tjera pasi regjistrimet zakonisht organizohen pothuaj në të njëjtën dekadë në nivelin global.

Sipas rregullores të Bashkimit Evropian 2017<sup>3</sup>, regjistrimi i ardhshëm i popullsisë dhe banesave duhet të lidhet me vitin referues 2021.

Një rreshtim i tillë do t'i siguronte Kosovës një status simbolik të një kombi në mesin e vendeve evropiane duke lejuar krahasimin e të dhënave në regjion, Evropë dhe nivel botëror.

**Kështu, regjistrimi i Kosovës nuk duhet të vështrohet si një detyrë e izoluar vetëm nacionale por në të kundërtën, si një detyrë komplekse plotësisht e futur në një perspektivë shumë më të gjerë internacionale dhe madje edhe në perspektivë të gjerë gjeo-politike e që duhet të merret parasysh.**

---

<sup>3</sup> COMMISSION IMPLEMENTING REGULATION (EU) 2017/881, Done at Brussels, 23 May 2017

## 2. Nevoja për të dhënat e regjistrimit

Zhvillimet globale të ekonomisë, zhvillimi i tregjeve të reja, teknologjisë dhe hapja e horizonteve të reja janë faktorë shtytës që popullsia e një vendi gjithnjë e më shumë të jetë në lëvizje. Përveç faktorëve natyral të lëvizjes së popullsisë (shkalla e fertiliteti dhe mortaliteti) faktorët tjerë mekanike si migracioni (kombëtar dhe ndërkombëtar) janë faktorët përcaktues në trendet demografike të një vendi. Për shkak të këtyre zhvillimeve të mëdha në një kohë të shkurtër disa shtete (përfshi shtete evropiane) praktikojnë që të kenë dy regjistrime brenda një dekade.

Kosova gjatë kësaj dekade ka pësuar ndryshime të theksuara si në shkallën e fertilitetit, mortalitetit dhe migrimit. Përkundër këtyre ndryshimeve për shkak të kostos së lartë buxhetore, kapaciteteve dhe praktikave të mëparshme Kosova, regjistrimin e popullsisë do e aplikon të zhvillojë në çdo dekadë.

Regjistrimi i popullsisë 2021 ka një rëndësi tjetër shtesë për Kosovën duke marrë në konsideratë që në regjistrimin e fundit të vitit 2011 një pjesë e komuniteti serbë (4 komuna) nuk morën pjesë në regjistrim. Regjistrimi i vitit 2021 pritet të jetë gjithëpërfshirës bazuar në interesin e përgjithshëm të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Po ashtu, të dhënat nga regjistrimi i popullsisë 2021 do të jenë bazë e mirë për analizimin e trendeve demografike ndërmjet dy regjistrimeve, parashikimet si dhe burim për rifreskimin dhe azhurnimin e të dhënave për tërë sistemin statistikor të Kosovës.

*Kosova pas vitit 2020 do të jetë përafuar integriteteve evropiane dhe të dhënat nga regjistrimi do të jenë kryesore në atë fazë.*

Pra, regjistrimi përfaqëson një element të rëndësishëm të vet infrastrukturës statistikore, pasi që rezultatet e tij mundësojnë që të nxjerrin edhe mostra proporcionale për çdo anketë që i merr për bazë ekonominë shtëpiake si njësi themelore.

**Te dhënat e dalura nga regjistrimi i popullsisë pasi kanë të dhëna të detajuara, gjithëpërfshirëse dhe të shpërndara në nivelin më të vogël organizativ janë të dhëna multidimensionale për një vend, regjion, komunë vendbanim si dhe për institucionet ndërkombëtare.**

### 3. Regjistrimet e popullsisë i zbatojnë standardet internacionale

Duke e konsideruar rëndësinë e pasjes së të dhënave cilësore dhe të krahasueshme që i respektojnë parimet fundamentale të statistikave zyrtare të KB-së dhe BE-së, Kosova, do të zbatoje standardet ndërkombëtare dhe rekomandimet lidhur me principet dhe metodologjinë për kryerjen e regjistrimit të popullsisë 2021.

Vendet e BE-së si dhe kombet tjera që kanë shprehur gatishmërinë e tyre me strukturat e BE-së duhet të respektojnë kornizën e rregullatorit të përshkruar në dokumentet bazike:

- (1) “Konferenca e Rekomandimeve të Staticientëve Evropian për Regjistrimet e Përgjithshme të Popullsisë 2020” përgatitur në 2015 nga Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropë, në bashkëpunim me Zyrën Statistike të Komuniteteve Evropiane<sup>4</sup>;
- (2) “Rregullorja e Komisionit Evropian nr.1201/2009 e Parlamentit Evropian dhe ajo e këshillit të datës 30 nëntor 2009 mbi Regjistrimet e Popullsisë dhe Ekonomive Shtëpiake”<sup>5</sup>.
- (3) “Rregullorja e Komisionit Evropian nr.1151/2010 e Parlamentit Evropian dhe ajo e këshillit të datës 30 nëntor 2009 mbi Regjistrimet e Popullsisë dhe Ekonomive Shtëpiake në lidhje me modalitetet dhe strukturën e raporteve të cilësisë dhe formatin teknik për transmetimin e të dhënave”<sup>6</sup>.
- (4) “Principet dhe rekomandimet për regjistrimin e popullsisë, Versioni i tretë i përgatitur nga Departamenti i Statistikave të Çështjeve Ekonomike dhe Sociale”<sup>7</sup>.

**Kosova është e përkushtuar që të respektojë në përputhshmëri këto rekomandime të KB-së dhe të Komisionit Evropian, ashtu siç do të bëjnë vendet e regjionit.**

---

<sup>4</sup> [https://www.unecce.org/fileadmin/DAM/stats/publications/2015/ECECES41\\_EN](https://www.unecce.org/fileadmin/DAM/stats/publications/2015/ECECES41_EN), UNITED NATIONS New York and Geneva, 2015.

<sup>5</sup> <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/HR/TXT/?uri=celex:32009R1201>, Brussels 2009

<sup>6</sup> <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/HR/TXT/?uri=celex:32009R1201>, Brussels 2010

<sup>7</sup> [https://unstats.un.org/unsd/publication/seriesM/Series\\_M67rev3en.pdf](https://unstats.un.org/unsd/publication/seriesM/Series_M67rev3en.pdf), United Nations New York, 2017

## 4. Shtrirja dhe kostoja e regjistrimit në Kosovë

Ashtu si një pjesë e gjerë e shteteve, Kosova planifikon që regjistrimin e popullsisë dhe ekonomive shtëpiake ta zhvillojë në mënyrë tradicionale duke grumbulluar të dhënat për të gjitha ekonomitë shtëpiake prezentë në territorin e saj dhe grumbullimin e informatave për çdo anëtarë të saj si dhe mbi karakteristikat e ekonomive shtëpiake.

Një operacion i një shkalle të tillë të madhe kërkon vizatimin e hartës për tërë territorin, duke ndërtuar pyetësorë që i përshtaten kërkesave nacionale dhe internacionale për të dhënat, duke marrë parasysh specifikën lokale, mobilizimin dhe trajnimit e një vale të regjistruarëve, të kontrolluesve dhe mbikëqyrësve të organizuar në një skemë të hierarkisë piramidale, duke bashkëpunuar me administratat lokale për aspektet e logjistikës, bërjen e një fushate të mirë projektuar dhe me shumëdimensional, duke elaboruar dhe implementuar një strategji të shëndosh konsultative për të gjithë pjesëmarrësit dhe shfrytëzuesit e të dhënave, duke grumbulluar, përpiluar, analizuar dhe shpërndarë të dhëna të shumta.

Sipas llogarive më të fundit, organizimi i regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive shtëpiake në Kosovë do të kërkonte punësimin e rreth 2,500-7,600 regjistruarëve, rreth 350-400 mbikëqyrës; si dhe rreth 40-50 trajnues-instruktur njëherit krijimin e aq shumë komisioneve komunal të regjistrimit sa edhe të komunave që territori numëron. Përpunimi i të dhënave nuk do të jetë si në regjistrimin e kaluar (2011) kur u deshën një numër i konsideruar i stafit si dhe një kohe prej 7 muajve pasi gjatë regjistrimit do të përdoret metoda CAPI ku, të dhënat do të dërgohen në bazën e shënimeve (databasë) në formë elektronike për një kohë të shkurtër.

Kostoja totale e regjistrimit llogaritet në 12 milion € (apo rreth 6.5 euro për person) që përfaqëson një shumë të konsiderueshme krahasuar me fondet e zakonshme të ndara për punën statistikore.

Në pjesën e dytë të vitit 2018 ASK së bashku me institucionet tjera vendore do të organizojë një konferencë informuese me donatorë për mundësinë e mbështetjes financiare.

*ASK planifikon të propozojë që projekti i regjistrimit të popullsisë të mbështetet financiarisht rreth 40% nga qeveria e Kosovës dhe 60% nga donatorët.*

**Regjistrimi duke qenë një operacion financiarisht i kushtueshëm si dhe kompleks në aspektin statistikor, autoritetet Kosovare nuk mund të lejojnë ndërmarrjen e tij nëse ka rrezik që regjistrimi të mos realizohet (aspekti politik apo social).**

## 5. Puna përgatitore

Kosova – dhe veçanërisht Agjencioni Statistikor duhet të fillojë sa më parë përgatitjet për këtë operacion kompleks dhe masiv dhe mbarëkombëtarë. Meqenëse ASK-ja nuk do të ketë asistencë teknike sikurse në regjistrimin e vitit 2011 dhe kur asaj i shtojmë aktivitet e zhvilluara në kohë gjatë vitit 2005-2008 (dy pilot regjistrime të realizuara) si dhe zyre e staf të veçantë që merreshin me përgatitjet për regjistrimin e popullsisë është nevojë urgjente dhe prioritet i lartë që brenda një kohe të shkurtër të formohet një grup punues në kuadër të ASK-së që do të jetë bërthama e aktiviteteve të shumta që pritet dhe duhen realizuar.

- 1. Kohe a realizimit të regjistrimit.** ASK-ja planifikon që regjistrimi i popullsisë në terren të jetë në pjesën e parë të vitit 2021 me propozim datën 01 prill. Kjo për faktin si kohë optimale për përgatitje si dhe lidhshmërinë me regjistrimin e vitit 2011 si dhe me praktikën e mëparshme të regjistrimeve në Kosovë. Njëherit regjistrimi në pjesën e parë të vitit 2021 (01 prill) është si alternative më e aplikuar nga vendet tjera si dhe rekomanduar si afat optimal nga institucionet ndërkombëtare.
- 2. Struktura e dokumentit të hartës së rrugës.** Në vazhdim, të gjitha veprimet e nevojshme që duhet implementuar për një regjistrim të suksesshëm janë prezantuar në dritën e secilit aktivitet duke rekomanduar datën optimale si dhe përgjegjësit për realizimin e aktiviteteve.



## AKTIVITET KRYESORE, AFATI KOHOR DHE PERGJEGJËSIT PËR NJË REGJISTRIM TË SUKSESSHËM (deri te data e regjistrimit)

### 6. Struktura organizative

Agjencia e Statistikës së Kosovës duhet që jo më larg se pjesa e parë e vitit 2018 të formoi grupet kryesore të punës duke përfshirë edhe nëngrupet punuese.

### 7. Ligji

Kosova në regjistrimin e vitit 2011 kishte ligjin e veçantë "PËR REGJISTRIMIN E POPULLSISË, TË EKONOMIVE FAMILJARE DHE TË BANESAVE" (ligji Nr. 03/L-237, tetor 2010). Po ashtu Kosova, do të ketë ligjin e veçantë edhe për regjistrimin e vitit 2021. Meqenëse ligji i vitit 2010 në pjesën dërmuese ishte në harmoni me rekomandimet ndërkombëtare për regjistrime duke pasur bazën kryesore ai ka nevojë të amendamentohet marrë parasysh të gjeturat dhe sfidat nga regjistrimi i kaluar (2011) si dhe rekomandimet e fundit ndërkombëtare mbi legjislaturën e regjistrimeve të popullsisë. ASK-ja duhet të përgatit një plan mbi amendamentin e ligjit për regjistrimin e popullsisë 2021.

- **Emri i aktivitetit:** Ligji mbi regjistrimin e popullsisë 2021
- **Bartës i aktivitetit:** ASK-ZKM
- **Aktiviteti shtese:** dokument i veçantë planifikues mbi procedimin e ligjit (ASK)
- **Koha e fillimit të aktivitetit:** Nëntor 2018
- **Koha e realizimit të aktivitetit:** pjesa e dytë e vitit 2019 apo pjesa e parë 2020
- **Përgjegjës:** Parlamenti i Kosovës
- **Rezultatet:** Versioni final i ligjit të regjistrimit i miratuar

**ASK-ja duhet të propozojë anëtarët e grupit punues që do të punojnë në finalizimin e ligjit jo më vonë se fundi i muajit nëntor 2018 derisa grupi duhet të jetë operacional nga muaji janar 2019. ASK-ja gjatë vitit 2018 (maj 2018) duhet ta njoftojë zyrtarisht Qeverinë e Kosovës në kohë për futjen e ligjit në legjislaturën e vitit 2019 për aprovim apo në fillim të vitit 2020.**

## 8. Buxheti

Bazuar në përvojën nga regjistrimi I vitit 2011 ku, kostoja e regjistrimit të popullsisë për një banor ishte 6.8 euro vlerësohet se kostoja e regjistrimit të popullsisë në vitin 2021 do të jetë e përafërt rreth 7 euro për person kjo për faktin rritja e kostos dhe standardit krahasuar me vitin 2011. ASK-ja duhet të përgatisë draftin e buxhetit jo më larg se në muajin tetor 2018 derisa buxhetin final deri në mesin e muajit qershor 2019.

ASK-ja vlerëson se duke u bazuar në rëndësinë e të dhënave edhe për institucionet ndërkombëtare, kapacitetet financiare të Kosovës, praktikën e mëparshme si dhe nga takimet me institucionet ndërkombëtare ku, BE do të mbështesë disa vende të Ballkanit shpresohet se regjistrimi I popullsisë do të mbështet në pjesën më të madhe nga donatorët. Propozohet që buxheti të jetë i sigurtar: 60% nga donatorët si dhe 40% Kosova. Përveç mundësisë së mbështetjes, diskutimi do të jetë i dobishëm edhe për:

menaxhimin e buxhetit, kohën optimale të financimit si dhe çështjet tjera operacionale.

- **Emri i aktivitetit:** Buxheti për regjistrimin e popullsisë 2021
- **Bartës i aktivitetit:** ASK-ZKM
- **Aktiviteti shtese:** dokument i veçantë përgatitur nga ASK-ja.
- **Koha e fillimit të aktivitetit:** Drafti -Tetor 2018
- **Buxheti final:** Qershor 2019
- **Përgjegjës:** Qeveria, MF dhe Parlamenti i Kosovës (dhjetor 2019)
- **Rezultatet:** Buxheti i disponueshem për aktivitete

**ASK-ja duhet të caktojë një person përgjegjës i cili do të llojë tek institucionet vendore dhe ndërkombëtare për sigurimin e buxhetit në kohë përfshi planifikimin detaj sipas aktiviteteve, kostos dhe kohës së realizimit. Në pjesën e dytë të vitit 2018 (Nëntor) ASK së bashku me institucionet tjera vendore do të organizojë një konferencë informuese me donatorë për mundësinë e mbështetjes financiare. Konferenca për financim (zotim) duhet të mbahet jo më larg se muaji qershor 2019.**

## 9. Metodologjia

ASK-ja do të respektojë standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare për regjistrimin e vitit 2021 me qëllim që ato të jenë të krahasueshme, pranueshme dhe të jenë në harmoni me regjistrimin e kaluar (2011). Përveç temave (pyetjeve-pikave) kryesore që do të implementohen. ASK-ja do të implementojë edhe pyetjet që janë interesi nacional me fokus migrimin dhe demografinë.

Në fund të vitit 2018 ASK-ja duhet të ngitë grupin punues që do të merret me harmonizimin e pyetësorit derisa pyetësori si draft duhet të jetë i gatshëm jo më larg se muaji qershor 2019.

- **Emri i aktivitetit:** Pyetjet në regjistrimin e popullsisë 2021
- **Bartës i aktivitetit:** ASK-demografia-grupi punues
- **Aktiviteti shtese:** dokument i veçantë përgatitur nga ASK-ja.
- **Koha e fillimit të aktivitetit:** Nëntor 2018
- **Drafti i pyetësorëve:** Qershor 2019
- **Përgjegjës:** ASK
- **Rezultatet:** Pyetësori i finalizuar (nëntor 2019)

**Grupi punues për finalizimin e pyetësorëve është i thirrur që të bëjë edhe planin që do të përmbajë edhe: kohën për analizim, tabelim, kohën e publikimit të të dhënave preliminare, publikimin e të dhënave finale si dhe raportet tjera tematike që do të publikohen.**

## 10. Grumbullimi i të dhënave në terren (TI)

Përkundër zhvillimeve teknologjike dhe qasjes në internet të pjesës dërmuese të Kosovës (mbi 88.8 % të ekonomive familjare<sup>8</sup>) Kosova planifikon që regjistrimin e popullsisë dhe ekonomive shtëpiake ta zhvillojë në mënyrë tradicionale duke grumbulluar të dhënat për të gjitha ekonomitë shtëpiake prezentë në territorin e saj dhe grumbullimin e informatave për çdo anëtarë të saj si dhe mbi karakteristikat e ekonomive shtëpiake.

---

<sup>8</sup> Anketa e teknologjisë informative: Agjencia e Statistikave të Kosovës:  
<http://ask.rks-gov.net/media/3828/tik-2017.pdf>

Ndryshimi ndërmjet regjistrimit të vitit 2011 dhe atij të planifikuar të vitit 2021 se grumbullimi nuk do të bëhet përmes formularëve por përmes tabletave (CAPI). Aplikimi i kësaj metode do të jetë sfidë e veçantë për ASK-në dhe në përgjithësi për regjistrimin. ASK-ja është në proces e sipër për aplikimin e kësaj metode që do të përdoret për herë të parë nga muaji Maj 2018 tek anketa e EU-SILC.

ASK-ja planifikon që gjatë këtij viti ta shtrijë/ aplikon këtë metode edhe tek anketa tjera derisa nga viti i ardhshëm pothuaj të gjitha anketat do të grumbullohen përmes kësaj metode. Ky është një rast shumë i rëndësishëm dhe në kohën e duhur dhe eksperiencë e mire për projektin e regjistrimit të popullsisë 2021.

- **Emri i aktivitetit:** Metodologjia e grumbullimit të të dhënave në regjistrimin e popullsisë 2021
- **Bartës i aktivitetit:** ASK-TI, stafi i angazhuar
- **Aktiviteti shtese:** dokument i veçantë përgatitur nga ASK-ja, mars 2019).
- **Koha e fillimit të aktivitetit:** Zhvillimi i aplikacionit-qershor 2019
- **Koha e realizimit të aktivitetit:** Aplikacioni i finalizuar-nëntor 2019
- **Përgjegjës:** ASK
- **Rezultatet:** Aplikacioni i gatshëm për pilot dhe regjistrimin e plote

**Dokumenti i TI duhet të përmbajë: kohën e zhvillimit të aplikacionit, pajisjet e nevojshme dhe kohën e posedimit të pajisjeve, sigurimin e të dhënave, konfidencialitetin si dhe aspektet tjera të rëndësishme.**

## 11. Hartografia/GIS

Hartografia do të jete pjese bazike për gjithëpërfshirës dhe kualitetin e të dhënave. Gjate pjesë se dytë të vitit 2019 dhe pjesës së parë 2020 ASK-ja do të bëjë azhurnimin e Qarqeve Regjistruese (QR) për tërë territorin e saj.

Diskutimet e para dhe rekomandimet janë që dy (2) QR si njësi statistikore të jenë të bashkuara në vetëm një QR. Kjo do të ketë impakt në ndarjen e re të QR dhe numri i tyre do të jetë përgjysmë sa numri i QR të vitit 2011.

Ndarja e tillë do të ndikojë edhe në numrin e personelit të angazhuar si dhe kohëzgjatjen e regjistrimit në terren. Pritjet janë që personeli i angazhuar në regjistrimin e vitit 2021 do të jetë i përgjysmuar. Azhurnimi dhe unifikimi i QR do të jetë sfidë në vete rreth përgatitjeve për regjistrimin 2021.

- **Emri i aktivitetit:** Hartat për regjistrimin e popullsisë 2021
- **Bartës i aktivitetit:** ASK-hartografia/GIS
- **Aktiviteti shtese:** dokument i veçantë përgatitur nga ASK-ja.
- **Koha e fillimit të aktivitetit:** Nëntor 2018
- **Drafti i dokumentit:** Mars 2019
- **Dokumenti final:** Qershor 2019
- **Puna në terren:** Tetor-nëntor-dhjetor 2019 dhe mars-prill 2020
- **Përgjegjës:** ASK
- **Rezultatet:** Hartat të gatshme (prill 2020)

## 12. Logjistika

Aplikimi i metodës CAPI gjatë grumbullimit të të dhënave përkundër sfidave të reja do të jetë një ndihmesë e madhe në aspektin logjistikë mbi shpërndarjen dhe grumbullimit të të dhënave nga terreni krahasuar me regjistrimin e vitit 2011. Logjistika duhet të jetë e fokusuar në hapësirat e nevojshme për trajnime, pajisjet e nevojshme përfshi shpërndarjen e dhe grumbullimin e tyre, materialeve tjera (me fokus materialet e komunikimit) si dhe aspektet tjera logjistike.

- **Emri i aktivitetit:** Logjistika për regjistrimin e popullsisë 2021
- **Bartës i aktivitetit:** ASK
- **Aktiviteti shtese:** dokument i veçantë përgatitur nga ASK-ja.
- **Koha e fillimit të aktivitetit:** Janar 2019
- **Drafti i dokumentit:** Mars 2019
- **Dokumenti final:** Tetor 2019
- **Përgjegjës:** ASK
- **Rezultatet:** Plani i logjistikës i gatshëm

**Plani i logjistikës do të hartohet në bashkëpunim me të gjitha grupet punuese marrë për bazë ndër lidhshmërinë e procesit. Plani do të azhurnohet gjatë gjithë kohës varësisht prej aktiviteteve dhe kohës.**

## 13.Komunikimi

Fokus i veçantë do ti jepet fushatës komunikuese si dhe instrumentet që do të aplikohen gjatë regjistrimit. Komunikimi do të jetë i fokusuar në pyetjet sensitive (rezident) përfshi: etnicitetin, religjionin, gjuhën si dhe numrin personal. Çështje e rëndësishme është edhe përfshirja e banoreve jo rezident që do të duhet të jenë pjesë e aktivitetit (grumbullimit) të të dhënave.

Rekomandohet që të aplikohet formulari i veçantë për popullsinë jo rezidentë duke rritur numrin e pyetjeve. Fushata komunikuese duhet të fillojë jo më larg se fillimi i vitit 2019 me një intensitet më të vogël (faze e I-rë) si dhe përgatitjen e draft dokumentit strategjik deri në muajin qershor 2019 si dhe finalizuar në fund të vitit 2019.

Që në fillim të vitit 2020 duhet implementuar strategjinë e komunikimit me një fushatë të mirë informuar dhe gjithëpërfshirëse me takime të shumta, komunikime, debate, reklama etj.

Në fillim të vitit 2021 do të jetë faza intensive e komunikimit duke përdorur instrumente të veçanta për pjesëmarrje të të gjithë popullsisë së Kosovës. Kostoja e përafërt për fushatën komunikuese do të jetë nga 3-4% e buxheti të përgjithshëm.

- **Emri i aktivitetit:** Fushat komunikuese për regjistrimin 2021
- **Bartës i aktivitetit:** ASK/komunikimi
- **Aktiviteti shtese:** dokument i veçantë përgatitur nga ASK-ja.
- **Koha e fillimit të aktivitetit:** Janar 2019
- **Drafti i dokumentit:** Qershor 2019
- **Dokumenti final:** Nëntor 2019
- **Përgjegjës:** ASK
- **Rezultatet:** Plani i komunikimit i gatshëm (2019) si dhe implementimi

**ASK-ja duhet të krijoj një grup të veçantë punuese do të përgatisë strategjinë e komunikimit si dhe implementimin e fushatës. Po ashtu, ASK-ja duhet të përfshijë në fushatën komunikuese persona me ndikim tek komunitetet gjatë fushatës intensive reklamuese dhe të komunikimit direkt. Sfide e veçante mbetet komunikimi.**

## 14.Administrata

Pas definimit të “Fondit për regjistrim” ASK duhet të përcaktohet për menaxhimin e buxhetit. Varësisht nga marrëveshja që do të jetë mes institucioneve vendore dhe donatorëve do të varet respektimi dhe implementimi i ligjeve, rregulloreve apo udhëzueseve të tjera legjislative në administratë.

Administrata duhet të jetë e fokusuar në sigurimin e fondeve në kohë, menaxhimin e tyre, shpalljen e kontratave dhe shumë e rëndësishme realizimin e tyre në kohë, nënshkrimin e kontratave, angazhimin e personelit etj. Sfidë do të jetë edhe furnizimi me pajisje në kohën e duhur.

Po ashtu, duhet të sigurojë kushtet e punës gjatë aktiviteteve përgatitore. Gjatë fund vitit 2018 ASK/administrata duhet të sigurojë së paku një hapësirë punuese (10-15 persona) derisa gjatë vitit 2019-2021 duhet të jenë s’paku dy zyre të nevojshme vetëm për regjistrimin e popullsisë që do të përfshinin: zyre për takime pune të të angazhuarve në regjistrim, takime me shfrytëzues e media, diskutime, prezantime, ruajtje të materialeve.

Takimet nga fillim viti 2019 duhet të jene takime të rregullta (ditore) dhe javore.

- **Emri i aktivitetit:** Administrata për regjistrimin 2021
- **Bartës i aktivitetit:** ASK/administrata
- **Aktiviteti shtese:** dokument i veçantë përgatitur nga ASK-ja.
- **Koha e fillimit të aktivitetit:** Janar 2019
- **Drafti i dokumentit:** Mars 2019
- **Dokumenti final:** Qershor 2019
- **Përgjegjës:** ASK
- **Rezultatet:** Plani i administratës i gatshëm si dhe implementimi

**Marrë parasysh respektimin e procedurave ligjore për blerje/furnizim me pajisje dhe angazhimin e stafit (expert, shërbyes civil, pjesë e personelit si dhe nga institucionet tjera publike) dhe kur kësaj i shtohet se aktivitet janë të ndërvarur nga aktivitet tjera administrata duhet të bëjë planin detal duke paraqitur riskun që mund të jenë pengesa reale në procesin e regjistrimit 2021. Shpërndaja e buxhetit në kohë sipas aktiviteteve do të jete sfidë e veçantë.**

## 15. Testet para regjistrimit

Për shkak të implementimit të metodës CAPI në regjistrimin e vitit 2021 ASK-ja planifikon që të zhvillojë disa teste (3-5) paraprake me fokus tek metoda CAPI në terren, transmetimi i të dhënave si dhe monitorimi. E rekomanduar që gjatë vitit 2019 pasi të jetë finalizuar baza e të dhënave (Aplikacioni) të zhvillohen dy teste. Po ashtu para pilot regjistrimit e rekomanduar të testohen edhe njëherë instrumentet e regjistrimit. Teste tjera mund të realizohen nga grupet punuese (hartografia, metoda e trajnimit, komunikimi etj.) varësisht prej nevojës por jo më larg se mesi i vitit 2020.

- **Emri i aktivitetit:** Testet për regjistrimin e popullsisë 2021
- **Bartës i aktivitetit:** ASK/grupet punuese
- **Aktiviteti shtese:** dokument i veçantë përgatitur nga ASK-ja.
- **Koha e fillimit të aktivitetit:** Janar 2019
- **Drafti i dokumentit:** Mars 2019
- **Dokumenti final:** Qershor 2019
- **Përgjegjës:** ASK dhe grupet punuese
- **Rezultatet:** Plani i testeve i gatshëm si dhe implementimi
- 

**Rëndësia e testeve paraprake është vitale për një regjistrim të suksesshëm andaj për secilin test të realizuar duhet të hartohet një raport specifik (intern) mbi të gjeturat dhe rekomandimet). Testet para regjistrimit të popullsisë duhet të përfundojnë jo më larg se mesi i vitit 2020.**

## 16. Pilot regjistrimi

ASK-ja për regjistrimin e popullsisë 2021 kishte zhvilluar tri (3) pilot marrë parasysh metodën dhe se regjistrimi i popullsisë 2011 ishte zhvilluar për herë të parë. Për regjistrimin e popullsisë 2021 ASK-ja planifikon të zhvillojë vetëm një pilot ku do të testohen të gjitha instrumentet sikurse tek regjistrimi i përgjithshëm.

Propozohet që realizimi i pilotit të zhvillohet në pjesën e parë të vitit 2020 (rekomanduar muaji prill 01-30).

Raport i veçantë (Intern) duhet të përgatitet mbi të gjeturat dhe rekomandimet për përmirësimin e tyre.

Mostra propozohet të jetë rreth 1.5 e popullsisë apo rreth 25.000 banorë.



## 17.Regjistrimi në terren

Koha optimale e regjistrimit të përgjithshëm do të rekomandohet të jetë muaji prill 2021. Me qëllim të gjithë përfshirjes, kualiteti të të dhënave përfshi aspektin logjistikë e administrativë si dhe përvojën nga regjistrimi i popullsisë së vitit 2011<sup>9</sup> grumbullimi i të dhënave në terren do të zgjasë një (1) muaj.

Kjo kohë optimale për grumbullimin e të dhënave në terren do ti mundësojë që stafi i angazhuar në terren të kenë qasje më të mirë si në aspektin orientues, gjithëpërfshirës si dhe rritjen e kualitetit të të dhënave.

Nga praktikat e mëparshme ditët e para (2-3 ditët) ishin të vështira për regjistruarit njëkosishtë edhe për mbikëqyrësit. Angazhimi i stafit për më shumë se një muaj do të jetë inkurajues për punën në terren.

Po ashtu, aspekti logjistikë dhe administrativë do të jetë i përgjysmuar krahasuar me regjistrimin e vitit 2011 në shpërndarjen e materialeve, hapësirat për trajnime, shpërndarjen/grumbullimin e materialeve/pajisjeve. Aspekt i rëndësishëm është edhe ai financiar ku kostoja e angazhimit të rreth 50% te stafit nënkupton kursim të buxhetit për pajisje dhe aktivitete në rreth 50%. Në aspektin statistikor nuk paraqet asnjë devijim statistikor bazuar që shumë shtete kanë aplikuar dhe aplikojnë një kohëzgjatje të tillë njëherit është si rekomandim ndërkombëtarë. Vlerësohet se numri i regjistruarëve të angazhuar të sillet ndërmjet 2500-2700 (2700 përfshi rezervën) si dhe 350-400 mbikëqyrës.

Po ashtu, nga ASK dhe institucionet tjera qendrore do të angazhohen rreth 40-50 trajnues-instruktur).

- **Emri i aktivitetit:** Regjistrimi i popullsisë ne terren, 2021
- **Bartës i aktivitetit:** ASK/institucionet tjera, komunat dhe stafi i angazhuar
- **Aktiviteti shtese:** dokument i veçantë përgatitur nga ASK-ja.
- **Koha e fillimit te aktivitetit:** Prill 2019
- **Drafti i dokumentit:** Nëntor 2019
- **Dokumenti final:** dhjetor 2019
- **Përgjegjës:** ASK dhe grupet punuese
- **Rezultatet:** Plani i regjistrimit ne terren

**Koha e realizimit ne terren do te këtë impakt të drejtpërdrejt në: angazhimin e stafit, buxhete, trajnime, pajisje dhe shumë aktivitete tjera. Andaj, përcaktimi në kohë për kohëzgjatjen e regjistrimit në teren është crucial të merret jo me larg se fund viti 2018.**

## 18. Anketa post regjistruese (APS/PES)

Gjatë vitit 2011 ASK-ja ka implementuar anketën post regjistruese e njohur si PES për te vlerësuar: mbulueshmërinë si dhe kualitetin e të dhënave. Njeherit është rekomandim ndërkombëtarë që të zhvillohet PES në projekte të tilla. Përvoja e vitit 2011 na sugjeron qe mostra duhet të jetë me e madhe për të nxjerre rezultate reprezentative. Andaj, sugjerohet që mostra të jete nga 1-1.3% e popullsisë.

- **Emri i aktivitetit:** Anketa post regjistruese, 2021
- **Bartës i aktivitetit:** ASK/metodologjia
- **Aktiviteti shtese:** dokument i veçantë përgatitur nga ASK-ja.
- **Koha e fillimit te aktivitetit:** Prill 2019
- **Drafti i dokumentit:** Nëntor 2019
- **Dokumenti final:** dhjetor 2019
- **Përgjegjës:** ASK dhe grupet punuese
- **Rezultatet:** Plani i APS

## 19. Analizimi dhe tabelimi

Sfida e analizimit të të dhënave do të jetë një ndër komponentët e rëndësishme që duhet kushtuar kujdes gjatë planifikimit. Vlerësohet se grumbullimi i të dhënave me anë të metodës CAPI do të rrisë në masë të madhe kualitetin e të dhënave por sfidë mbetet analizimi i tyre marrë parasysh numrin e madhu të indikatorëve që do të jenë pjesë e grumbullimit të të dhënave. Harmonizimi, inputimi, pastrimi, analizimi, tabelimi si dhe përgatitja e raporteve finale do të jenë sfida kryesore pas regjistrimit.

Kësaj duhet shtuar edhe dërgim i të dhënave ne EUROSTAT sipas standardeve (Census HUB table si dhe të dhënat e disagreguara deri në nivelin e 1km<sup>2</sup>).

- **Emri i aktivitetit:** Analizimi dhe tabelimi nga regjistrimi 2021
- **Bartës i aktivitetit:** ASK/gjithë stafi i angazhuar
- **Aktiviteti shtese:** dokument i veçantë përgatitur nga ASK-ja.
- **Koha e fillimit të aktivitetit:** Prill 2020
- **Drafti i dokumentit:** Nëntor 2020
- **Dokumenti final:** dhjetor 2020
- **Përgjegjës:** ASK dhe grupet punuese
- **Rezultatet:** Plani i analizimit dhe tabelimit

**ASK-ja bazuar në përvojën nga regjistrimi 2011 duhet të përgatisë edhe "Raportin e kualitetit" i rëndësishëm për ASK/shfrytëzuesit si dhe njëherit është standard ndërkombëtar. Fokus i veçantë i ASK duhet të jetë analizimi dhe tabelimi në kohë. Baza e të dhënave duhet të jetë lansuar në web faqen e ASK-së jo më larg se dy (2) vite pas regjistrimit.**

## 20. Të dhënat preliminare

Të dhënat preliminare me disa indikatorë bazik duhet të publikohen jo më larg se tre (3) muaj nga data e fundit e regjistrimit në terren. Edhe pse raporti preliminar përmban vetëm disa të dhëna me tabela është sfide e veçantë pasi baza e të dhënave për indikatorët që do të publikohen duhet të jetë e pastruar pothuaj vetëm dy muaj pas regjistrimit.

- **Emri i aktivitetit:** Te dhënat preliminare nga regjistrimi 2021
- **Bartës i aktivitetit:** ASK/te gjitha grupet punuese
- **Aktiviteti shtese:** dokument i veçantë përgatitur nga ASK-ja.
- **Koha e fillimit të aktivitetit:** Prill 2020
- **Pastrimi i bazës së të dhënave:** Maj 2021
- **Drafti i dokumentit:** Maj 2021
- **Dokumenti final:** qershor 2021
- **Publikimi/konferenca:** qershor 2021
- **Përgjegjës:** ASK dhe grupet punuese
- **Rezultatet:** Plani detali për publikimin e të dhënave preliminare

**Përgatitja e të dhënave preliminare është sfidë që duhet planifikuar në detaje pasi pritja (presioni) e publikut është shumë e madhe dhe të dhënat duhet të jenë pothuaj identike me ato që do të publikohen si të dhëna finale. Përveç pastrimi dhe analizave, tabelimit përgatitja e raportit sfidë është edhe përkthimi, dizajnimi e lekturimi të gjitha duhet të jenë në kohë optimale.**

## 21. Të dhënat finale

Të dhënat finale duhet të publikohen jo më larg se gjashtë (6) muaj pas regjistrimit. Propozohet që të dhënat e para finale të publikohen në pjesën e parë të muajit tetor 2021. Të dhënat finale përfshijnë një raport me të dhënat bazike me fokus të dhënat në nivel vendi.

- **Emri i aktivitetit:** Të dhënat finale nga regjistrimi 2021
- **Bartës i aktivitetit:** ASK/te gjitha grupet punuese
- **Aktiviteti shtese:** dokument i veçantë përgatitur nga ASK-ja.
- **Koha e fillimit të aktivitetit:** Prill 2020
- **Pastrimi i bazës së të dhënave:** Maj-Korrik 2021
- **Drafti i dokumentit:** Shtator 2021
- **Dokumenti final:** Shtator 2021
- **Publikimi/konference:** Tetor 2021
- **Përgjegjës:** ASK dhe grupet punuese
- **Rezultatet:** Plani detal për publikimin e të dhënave finale

**Sfida të njëjta si tek tek dhënat preliminare do të paraqitet edhe nxjerrja e të dhënave të para finale marrë parasysh kohën e shkurtër për të nxjerrë raporte finale. Një plan detal dhe monitorues është i nevojshëm për nxjerrjen e raportit në kohë.**

## 22. Raportet tjera specifike

ASK duhet të përgatit planin e raporteve specifike duke përfshirë kalendarin e publikimit të këtyre raporteve. Po ashtu, duhet të përcaktohen në kohë angazhimi i stafit nga institucionet tjera varësisht prej tematikës së raportit.

- **Emri i aktivitetit:** Raportet tematike nga regjistrimi 2021
- **Bartës i aktivitetit:** ASK/të gjitha grupet punuese
- **Aktiviteti shtese:** dokument i veçantë përgatitur nga ASK-ja.
- **Koha e fillimit të aktivitetit:** Qershor 2021
- **Drafti i dokumentit:** Korrik 2021
- **Dokumenti final:** Tetor 2021- Dhjetor 2023
- **Publikimet tematike:** 2021-2023
- **Përgjegjës:** ASK dhe grupet punuese
  
- **Rezultatet:** Kalendari i publikimeve dhe raportet tjera tematike

## 23. Dërgimi i të dhënave tek institucionet lokale dhe ato ndërkombëtare / diseminimi

ASK duhet ta përgatisë planin detal për shpërndarje dhe dërgimin e të dhënave tek institucionet tjera vendore dhe ato ndërkombëtare në harmoni me legjislacionin në fuqi si dhe në formatin e pre definuar që më parë. Një grup i veçantë duhet të përgatisë planin se cilat të dhëna do të jenë të disponueshme për publikun e gjerë, cilat të dhënat do t'iu jepen institucioneve të caktuara si dhe dërgimi i të dhënave në Eurostat.

- **Emri i aktivitetit:** Dërgimi i të dhënave tek institucionet tjera
- **Bartës i aktivitetit:** ASK/te gjitha grupet punuese
- **Aktiviteti shtese:** Dokument i veçantë përgatitur nga ASK-ja.
- **Koha e fillimit të aktivitetit:** Qershor 2021
- **Drafti i dokumentit:** Korrik 2021
- **Dokumenti final:** Tetor 2021- Dhjetor 2023
- **Publikimet tematike:** 2021-2023
- **Përgjegjës:** ASK dhe grupet punuese
- **Rezultatet:** Dërgimi i të dhënave në format të caktuar dhe në kohë

## 24.Regjistri i popullsisë/lidhja me bazat tjera

I një rëndësie të veçantë regjistrimi i popullsisë 2021 është se ASK vlerëson se ky do të jetë regjistrimi i fundit duke aplikuar metodën tradicionale të grumbullimit të të dhënave në terren (derë me derë).

